Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education and Science

**UDHËZIM ADMINISTRATIV( MASH) NR. 85 /2020 PËR KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2020/2021**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES) NO. 85 /2020 FOR SCHOOL YEAR CALENDAR 2020/2021**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MON) BR. 85 /2020 ŠKOLSKI KALENDAR ZA 2020/2021**

| | | |
|---|---|---|
| **Ministri i Arsimit dhe Shkencës,**<br>Në mbështetje të nenit 5 paragrafit 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011), në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 06/2020 dhe shtojcës 11 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020), nxjerr: | **The Minister of Education and Science,**<br>Pursuant to Article 5 paragraph 2 subparagraph 2.1 of the Law on Pre-University Education in the Republic of Kosova (Official Gazette No. 17, 16 September 2011), pursuant to Article 8 paragraph 1 sub-paragraph 1.4 of Regulation (QRK) no. 06/2020 and Annex 11 for the areas of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries (08.06.2020), issue: | **Ministar Obrazovanja i Nauke,**<br>Na osnovu član 5 stav 2 podstav 2.1 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju Republike Kosova (Službeni glasnik br, 17, 16 septembar 2011), član 8 stav 1 i podstav 1.4 i Uredbe br.06/2020 i aneks 11 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva (08.06. 2020) izdaje: |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASH) NR.______/2020 PËR KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2020/2021** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES) NO. ______/2020 FOR SCHOOL YEAR CALENDAR 2020/2021** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MONT) BR.______/2020 ZA ŠKOLSKI KALENDAR ŠKOLSKE GODINE 2020/2021** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**The purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| Ky Udhëzim administrativ, ka për qëllim të përcaktojë fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor, respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike për nxënësit e shkollave fillore, klasave parafillore, shkollave të mesme të ulëta, shkollave të mesme të larta, institucionet parashkollore dhe qendrat burimore për mësim dhe këshillim. | This Administrative Instruction aims to determine the beginning and end of the school year, respectively the academic year, according to levels, winter break, spring break, public holidays for primary school students, pre-primary classes, lower secondary schools, higher secondary schools, preschool institutions and resource centres for teaching and counselling. | Ovo Administrativno uputstvo ima za cilj da odredi početak i kraj školske godine, odnosno akademske godine, po nivoima, zimskim raspust, prolećni raspust, državni praznici za učenike osnovnih škola, predškolske razrede, niže srednje škole, više srednje škole, predškolske institucije i resorni centri za učenje i savetovanje. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 2**<br>**Viti shkollor**<br><br>Viti shkollor 2020/2021, do të fillojë me 14 shtator 2020 dhe do të përfundojë me 31 gusht 2021. | **Article 2**<br>**School year**<br><br>The school year 2020/2021 will begin on September 14th, 2020 and will end on August 31th, 2021. | **Član 2**<br>**Školska godina**<br><br>Školska godina 2020/2021, počinje 14 septembra 2020 i završava 31 avgusta 2021. |
| **Neni 3**<br>**Periudha e parë**<br><br>Periudha e parë fillon me 14 shtator 2020 dhe përfundon me 24 dhjetor 2020. | **Article 3**<br>**First period**<br><br>The first period begins on September 14th, 2020 and ends on December 24th, 2020. | **Član 3**<br>**Prvi period**<br><br>Prvi period počinje 14 septembra 2020 i završava 24 decembra 2020. |
| **Neni 4**<br>**Periudha e dytë**<br><br>Periudha e dytë fillon me 11 janar 2021 dhe përfundon me 26 mars 2021. | **Article 4**<br>**Second period**<br><br>The second period begins on January 11th, 2021 and ends on March 26th, 2021. | **Član 4**<br>**Drug period**<br><br>Drugi period počinje 11 januara 2021 i završava se 26 marta 2021. |
| **Neni 5**<br>**Periudha e tretë**<br><br>1. Periudha e tretë fillon me 6 prill 2021 dhe përfundon me 26 maj 2021, për nxënësit të cilët e përfundojnë shkollën e mesme të lartë klasën e 12-të (maturantët).<br><br>2. 17 qershor 2021, për nxënësit e | **Article 5**<br>**Third period**<br><br>1. The third period begins on April 6, 2021 and ends on May 26, 2021, for students who complete 12th grade of higher secondary school (graduates).<br><br>2. June 17th, 2021, for students in grades 9, | **Član 5**<br>**Treći period**<br><br>1.Treći period počinje 6. aprila 2021. godine i završava se 26. maja 2021. godine za učenike koji završavaju višu srednju školu 12-ti razred (maturanti);<br><br>2. 17 jun 2021, za učenike koji |

| | | |
|---|---|---|
| klasave 9, 10 dhe 11-të.<br><br>3. 30 qershor 2021, për nxënësit e klasave 1 - 8 dhe fëmijët parafillor. | 10 and 11.<br><br>3. June 30th, 2021, for students in grades 1-8 and pre-primary children. | završavaju 9, 19 i 11 razred;<br><br>3. 30 jun 2021, za učenike koji završavaju 1 - 8 razred i deca iz predškolsko; |
| **Neni 6**<br>**Praktika profesionale**<br><br>1. Përveç mësimit të rregullt, nxënësit do të kenë edhe forma tjera të mësimit siç është mësimi praktik dhe praktika profesionale.<br><br>2. Drejtorët e të gjitha shkollave profesionale, janë të detyruar që në planin vjetor të punës ta caktojnë kohën e mbajtjes së praktikës profesionale. | **Article 6**<br>**Professional practice**<br><br>1. In addition to regular teaching, students will have other forms of teaching such as practical teaching and professional practice.<br><br>2. The principals of all vocational schools are obliged that in the annual work plan to specify the time of holding the professional internship. | **Član 6**<br>**Profesionalna prakse**<br><br>1. Pored redovne nastave, učenici će imati i druge oblike učenja kao što su praktična nastava i profesionalna praksa.<br><br>2. Direktori svih profesionalnih škola dužni su da u godišnjem planu rada odrede vreme održavanje profesionalne prakse. |
| **Neni 7**<br>**Pushimet**<br><br>1. Pushimi dimëror, fillon më 28 dhjetor 2020 dhe mbaron më 8 janar 2021.<br><br>2. Pushimi pranveror, fillon më 29 mars 2021 dhe mbaron më 2 prill 2021. | **Article 7**<br>**Holidays**<br><br>1. The winter holidays begins on December 28th, 2020 and ends on January 8th, 2021.<br><br>2. The spring holidays begins on March 29th, 2020 and ends on April 2nd, 2021. | **Član 7**<br>**Odmori**<br><br>1. Zimski odmor počinje 28 decembra 2020 i završava 8 januara 2021.<br><br>2. Prolećni odmor počinje 29 mart 2021 i završava 2 aprila 2021. |

| **Neni 8**<br>**Festat publike, ditët kur pushohet** | **Article 8**<br>**Public holidays, non-working days** | **Član 8**<br>**Državni praznici, dani odmora** |
|---|---|---|
| 1. 28 nëntor 2020, Dita e Shqiptarëve, Dita e Pavarësisë së Shqipërisë, ditë pushimi 30.11.2020 | 1. November 28th, 2020, Albanians Day, Independence Day of Albania, non-working day 30.11.2020. | 1. 28 novembra 2020, Dan Albanaca Dan nezavisnosti Albanije, neradni dan 30.11. 2020 |
| 2. 25 dhjetor 2020, Krishtlindjet Katolike. | 2. December 25th, 2020 Catholic Christmas, | 2. 25 decembar 2020, Katolički Božić |
| 3. 17 shkurt 2021, Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. | 3. February 17th, 2020, Independence Day of the Republic of Kosova, | 3. 17 februar 2021, Dan nezavisnosti Republike Kosova. |
| 4. 04 prill 2021, Pashkët Katolike, ditë pushimi është më 05.04.2021. | 4. April 04th, 2020, Catholic Eastern, non-working day 05.04.2020. | 4. 04 april 2021, Katolički Uskrs, neradni dan je 05.04.2019. |
| 5. 9 prill 2021, Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. | 5. April 09th, 2020, Constitution Day of the Republic of Kosova. | 5. 9 februar 2021, Dan ustavnosti Republike Kosova. |
| 6. 1 maj 2021, Dita Ndërkombëtare e Punës, ditë pushimi është 03.05.2021. | 6. May 1st, 2021, International Labour Day, non-working day is 03.05.2021. | 6. 1 maj 2021, Međunarodni dan rada neradni dan je 03.05.2021 |
| 7. 02 maj 2021, Pashkët Ortodokse, ditë pushimi është më 03.05.2021. | 7. May 02nd, 2020, Orthodox Eastern, non-working day is 03.05.2021. | 7. 02 maj 2021, Pravoslavni Uskrs, neradni dan je 03.05.2021 |
| 8. 9 maj 2021, Dita e Evropës, ditë pushimi është më 10.05.2021. | 8. May 9th, 2021, Day of Europe, non-working day is 10.05.2021. | 8. 9 maj 2021, Dan Evrope, neradni dan je 10.05.2021 |
| 9. 13 maj 2021, Fitër Bajrami. | 9. May 13th, 2021, Eid al-Fitr | 9. 13 maj 2021, Fiter Bajram (Ramazanski Bajram). |
| 10. 12 qershor 2021, Dita e Paqes, ditë | 10. June 12th, 2021, Day of Peace, non- | 10. 12 jun 2021, Dan mir, neradni dan je |

| | | |
|---|---|---|
| pushimi është më 14.06.2021. | working day is 14.06.2021. | 14.06.2021. |
| **Neni 9**<br>**Ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës** | **Article 9**<br>**The compulsory days and weeks of learning and labour** | **Član 9**<br>**Dani i nedelje obavezni za održavanje nastave i rada** |
| 1. Për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturantët, janë të obliguara 160 ditë mësimi 32 javë. | 1. For secondary higher school students – graduates are obliged in 160 learning days – 32 weeks | 1. Za učenike više srednje škole - maturante, obavezno je 160 nastavnih dana– 32 nedelje. |
| 2. Për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të, janë të obliguara, 175 ditë mësimi 35 javë. | 2. For students of grades 9, 10 and 11 – are obliged, 175 learning days 35 weeks. | 2. Za učenike 9, 10. i 11-tog. razreda obavezana su 175 dana nastave i 35 nedelje. |
| 3. Për nxënësit e klasave 1- 8 dhe fëmijët parafillor, janë të obliguara 184 ditë mësimi 37 javë. | 3. For students of grades 1-8 and pre-primary students are obliged 184 learning days 37 weeks. | 3. Za učenike 1-8 razred i deca predškolskog, obavezna su 184 dani nastave -37 nedelje. |
| 4. Institucionet parashkollore duhet të marrin për bazë festat zyrtare në pajtim me nenin 8 të këtij udhëzimi. | 4. Preschool institutions must take into account the official holidays in accordance with Article 8 of this instruction. | 4. Predškolske institucije treba da imaju u vid državne praznike u skladu sa članom 8. ovog uputstva. |
| 5. Pushimet verore për institucionet parashkollore rregullohen nga institucionet parashkollore në bashkëpunim me DKA-në, gjatë periudhës kohore 1 korrik deri më 15 gusht, ku brenda kësaj periudhe kohore planifikojnë pushimin vjetor në bazë të ligjit të punës. | 5. Summer holidays for preschool institutions are regulated by preschool institutions in cooperation with MED, during the period July 1 to August 15, where within this time period plan annual holiday based on labour law | 5. Letni odmor za predškolske institucije regulišu predškolske institucije u saradnji sa ODO-om u periodu od 1. jula do 15. avgusta, što u ovom vremenskom periodu planiraju godišnji odmor n000a osnovu zakona o radu. |
| 6. Në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim me konvikt, në rast se festa është | 6. In resource centres for learning and counselling with dormitory, if the holiday is | 6. U resornim centrima za učenje i savetovanje sa smeštajem, ako je praznik |

| | | |
|---|---|---|
| gjatë ditëve të punës, u lejohet të planifikojnë zëvendësimin e mësimit, pa humbur nga ditët dhe javët e obliguara për mësim. | during working days, they are allowed to plan the substitution of the lesson, without losing the obligatory days and weeks for the lesson. | tokom radnih dana, dozvoljeno je da se planira zamena nastave, bez gubljenja obaveznih dana i nedelja za nastavu. |
| 7. Për çdo ndryshim të kalendarit shkollor, MASH merr vendim të veçantë. | 7. For each school calendar change, MES takes special decision. | 7. Za svaku promenu školskog kalendara, MON donosi posebnu odluku. |
| **Neni 10**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Article 10**<br>**Repealing provisions** | **Član 10**<br>**Van snažne odredbe** |
| Ky Udhëzim administrativ, shfuqizon UA nr. 18/2019 të datës 29.08.2019 dhe të gjitha udhëzimet administrative të mëparshme që kanë rregulluar këtë fushë. | This Administrative instruction repeals AI no. 18/2019 dated 29.08.2019 and all previous Administrative instructions that have regulated this area. | Ovo Administrativno uputstvo, stavlja van snagu AU br. 18/2019 datuma 29.08.2019 i sva ranija administrativna uputstva koja su regulisala ovu oblast |
| **Neni 11**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 11**<br>**Entry into force** | **Član 11**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare. | This Administrative instruction enters into force seven (7) days after its signing in the Official gazette. | Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavljivanja u Službeni glasnik. |
| **Ramë Likaj**<br>__________<br>**Ministër**<br>**Dt._____._____________** | **Ramë Likaj**<br>__________<br>**Minister**<br>**Date.____.____.______** | **Ramë Likaj,**<br>__________<br>**Ministar**<br>**Dat.______._______._________** |

REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit dhe Shkencës /Ministarstvo Obrazovanja i Nauke /Ministry of Education and Science

## KALENDARI PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021
## 14.09.2020 - 31.08.2021

| Muaji | Periudha e ditëve të mësimit | Numri i ditëve të mësimit | Festat | Mbarimi i vitit mësimor |
|---|---|---|---|---|
| Shtator | 14-30 | 13 ditë | | |
| Tetor | 1-30 | 22 ditë | | |
| Nëntor | 2-30 | 20 ditë | *Dita e shqiptarëve (Dita e Pavarësisë së Shqipërisë) 28.11.2020 | |
| Dhjetor | 1-24 | 18 ditë | Krishtlindjet Katolike 25.12.2020 | |
| | | | Përfundimi i periudhës së parë | |
| | | | Viti i Ri 2021 01.01.2021 dhe 02.01.2021 | |
| Pushimi Dimëror | | | 28.12.2020 - 08.01.2021 | |
| Janar | 11-29 | 15 ditë | | |
| Shkurt | 1-26 | 19 ditë | Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës 17.02.2021 | |
| Mars | 1-26 | 20 ditë | | |
| | | | Përfundimi i periudhës së dytë | |
| Pushimi Pranveror | | | (29.03.2021- 02.04.2021) | |
| Prill | 6-30 | 18 ditë | * Pashkët Katolikë 04 .04.2021<br>Dita e Kushtetutës 09.04.2021 | |
| Maj | 4-31 | 18 ditë | *Dita Ndërkombëtare e Punës 01.05.2020<br>* Pashkët Ortodokse 02.05.2021<br>*Dita e Evropës 09.05.2021<br>Fitër Bajrami 13.05.2021 | 26 maj 2021 Përfundimi i vitit mësimor për Klasën e 12-Maturantët |
| Qershor | 1-30 | 21 ditë | *Dita e Paqes 12.06.2021 | 17 qershor 2021 Përfundimi i vitit mësimor për klasën e 9, 10 dhe 11 |
| | | | | 30 qershor 2021 Përfundimi i vitit mësimor për Parafillorët dhe klasat 1- 8 |

* 28.11.2020 Dita e shqiptarëve (Dita e Pavarësisë së Shqipërisë), ditë pushimi është më 30.11.2020.
* 04 .04.2021 Pashkët Katolike, ditë pushimi është më 05.04.2021.
* 01.05.2021 Dita Ndërkombëtare e Punës, ditë pushimi është më 03.05.2021.
* 02.05.2021 Pashkët Ortodokse, ditë pushimi është më 03.05.2021.
* 09.05.2021 Dita e Evropës, ditë pushimi është 10.05.2021.
* 12.06.2021 Dita e Paqes, ditë pushimi është 14.06.2021.